

Gjimnazistët e Ulqinit vizituan qytetin e Beranës

Dialogu i të rinjve në diversitet



Pas një prezantimi të detajuar të resurseve dhe specifikave tjera që e karakterizojnë këtë komunë, nxënësit nga Ulqini dhe nxënësit vendas, vizituan Muzeun dhe galerinë e qytetit, shtëpinë muze të vojskës Gavro Vuković – ministrit të parë të punëve të jashtme në mbretërinë e Malit të Zi.

Të shtunën që shkoi, grupi i gjimnazistëve nga Ulqini, të cilët vijnë në programin "NATO dhe dialogu i të rinjve", vizituan qytetin e Beranës. Në kuadër të këtij aktiviteti, nxënësit nga Ulqini patën një pritje të ngrohtë në ndërtesën e Komunës së Beranës, të organizuar nga vetë Kryetari i Komunës z. Vuka Gollubović dhe nënkryetari z. Braho Adroviq. Pas një prezantimi të detajuar të resurseve dhe specifikave të tjera që e karakterizojnë këtë komunë, nxënësit nga Ulqini dhe nxënësit vendas, viz-

ituan Muzeun dhe galerinë e qytetit, shtëpinë muze të vojskës Gavro Vuković – ministrit të parë të punëve të jashtme në Mbretërinë e Malit të Zi. Më pas, të gjithë së bashku vizituan edhe Manastirin "Gjurgjevi stupovi" si dhe Përmendoren e lirisë në kodrën Jasikovac.

Ky udhëtim ishte vizitë kthyesë e të rinjve nga Ulqini, pasi bashkëmoshatarët e tyre nga Berana vizituan qytetin e Ulqinit gjatë muajit të kaluar. Gjatë qëndrimit në këtë qytet, nxënësit nga veriu i Malit të Zi

vizituan Qytetin e vjetër, Tyrbet në Plazhin e vogël, Xhaminë e detarëve dhe patën një pritje solemne në Komunën e Ulqinit, ku mesazhe përshëndetëse iu drejtuan nënkryetari i Komunës z. Met Gjoni dhe deputeti Genci Nimanbegu.

Të dy këto aktivitete ishin pjesë e projektit edukativ për integrimet euroatlantike, të cilin e realizojnë organizatat e shoqërisë civile "Horizonti i ri" nga Ulqini dhe "Spona" nga Berana, me mbështetjen e Ambasadës amerikane në Mal të Zi.